

V E N D I M
Nr. 372, datë 27.5.2001

**PËR FILLIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT E TË RISTRUKTURIMIT DHE
PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS E TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË
PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME “SERVCOM” FIER**

(Ndryshuar me VKM nr. 243, datë 24.4.2003)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 7, 8, 9 dhe 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të nenit 2 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Servcom”, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria anonome “Servcom” Fier t’i nënshtrohet procesit të ristrukturimit të plotë.
2. Nga “Servcom” sh.a., të shkëputen Uzina Mekanike Patos dhe Parku i Mallrave Patos. Privatizimi i këtyre njësive do të bëhet në përputhje me legjislacionin e privatizimit të sektorëve jostrategjikë.
3. Fillimin e procedurave për privatizimin e “Servcom”, sh.a. Fier. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të saj të tretëve.
4. Stuktura e formulës së privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë të jetë si vijon:
 - a) Jo më pak se 51 për qind e aksioneve të kapitalit të ofrohen për t’u shitur në lekë. Shuma e aksioneve të mësipërme të kapitalit të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur.
 - b) Jo më shumë se 20 për qind e aksioneve të kapitalit t’u ofrohet punonjësve të shoqërisë me anë të shkëmbimit me bonot e privatizimit, dhënë atyre nga shteti. Procedura e transferimit të bëhet sipas vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, kapitulli B pika 1 deri 5, vetëm për punonjësit e shoqërisë. Si punonjës të “Servcom” sh.a. që përfitojnë nga pika “b”, quhen punonjësit në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000, si dhe punonjësit e njësive të kësaj shoqërie, të dalë në asistencë me vendimin nr.422, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave.
 - c) Ish-pronarëve të truallit t’u ofrohen aksione sipas vlerës së përfshirë në kapitalin e shoqërisë, në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
 - d) Në ndryshim nga procedurat e përcaktuara në kapitullin I, shkronja B dhe C të vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, transferimi i paketave të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë për punonjësit dhe ish-pronarët e truallit të fillojë pas realizimit të shitjes me tender të paketës së aksioneve.
5. Formula e privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë dhe madhësia e paketave respektive përcaktohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë.
6. Punonjësit që dalin të tepërt nga procesi i ristrukturimit dhe i privatizimit të shoqërisë të cilët deri më datën 30.12.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune, të trajtohen për 1 (një) vit me pagën bazë. Shpenzimet që nevojiten për pagat e këtyre punonjësve, të përballohen nga të ardhurat e privatizimit të kësaj shoqërie.
7. Periudha 1 (një) - vjeçare për këta punonjës të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.
8. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari

ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

9. Kontributet e papaguara, së bashku me kamatëvonesat që “Servcom” sh.a. ka ndaj sigurimeve shoqërore deri në datën 30.12.2000, e që arrijnë vlerën 178.185.000 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, të shlyhen brenda 30 ditëve nga arkëtimet që do të realizohen nga privatizimi i shoqërisë.

10. Pagesa e punonjësve që dalin tepër nga zbatimi i këtij vendimi të bëhet nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse, pas transferimit të fondit financiar nga “Servcom” sh.a.

11. Ngarkohen *Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave* për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta